



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ BEQIR ÇELA “ DURRËS

Nr. 180 Prot

Durrës , më 02.09.2020

Lenda: Njoftim për vende të lira pune

Sektorit të burimeve njerëzore

Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse

Drejtuar: AGJENSISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

TIRANË

Bazuar në ligjin nr 15 datë 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë , vendimit të këshillit të ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjensisë Kombëtare të punësimit dhe Aftësive në Udhëzimin nr 11 datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe në udhëzimin nr 28 date 14.10.2019 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional “(fletore zyrtare 2020 –numri 12) , ju njoftojmë për vende të lira pune për pozicionet e mëposhtme:

- 1- Mësimdhënës të teorisë profesionale në drejtimin Shërbime Mjete Transporti - 2(nje) mesues
- 2- Mësimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin Shërbime Mjete Transporti - 2(dy) mesues
- 3- Mësimdhënës të teorisë profesionale në drejtimin Elektroteknike e Integruar me Elektroniken - 1(nje) mesues
- 4- Mësimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin Elektroteknike e Integruar me Elektroniken - 2(dy) mesues
- 5- Mësimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin e TIK - 2 (dy) mesues
- 6- Mesimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin Instalues I Sistemeve Termohidraulike – 1 (nje) mesues

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

3. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose të nivelit bachelor në një nga profilet, që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Ju faleminderit !

DREJTOR

Fatmir MERKURI

